



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2019:150738
Datë: 23.10.2023
Numri i dokumentit: 04817869

C-III-23-0227

Paditësja

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) Rr. ‘Dritan Hoxha’ nr.55, Lakrishte, Prishtinë

kundër

E paditura

Komuna e Junikut

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), Kolegji i përbërë nga Gazmend Sylaj gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha gjyqtare dhe Hasim Sogojeva gjyqtar, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 tetor 2023, merr këtë:

AKTVENDIM

- 1. Refuzohet kërkesa e paditëses për lëshimin e masës së sigurisë.**
- 2. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 7 korrik 2010, pranë Gjykatës Komunale në Deçan, tani Gjykata themelore në Pejë – Dega në Deçan (në tekstin në vijim lexo: GJTHP-DD) paditësja, parashtron një padi pronësore me të cilën u kërkua që e paditura Komuna e Junikut, të obligohet që në emër të dëmit të shkaktuar me rrënimin e objektit – supermarketit në Junik, pronë e NSHT “16 Q” D, paditëses ti paguhet shuma prej 412.570 (katër një dy pesë shtatë) Euro.

Paditësja kërkon kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Me një parashtrësë të veçantë të dorëzuar pranë GJTHP-DD, po me 7 korrik 2010, paditësja kërkon nga gjykata lëshimin e Masës së Sigurisë (tani e tutje lexo: MS). Paditësja kërkon nga gjykata të caktohet Masa e Përkohshme dhe ti ndalohet të paditurës, Komuna e J, tjetërsimi dhe

punët ndërtimore në ngastrën kadastrale nr. 1375/2 në sipërfaqe prej 00.05.50 ha, e evidentuar sipas listës poseduese nr. 987 (në tekstin në vijim lexo: prona kontestuese) , Zona Kadastrale J.

Me padi-MS, respektivisht nga shkresat e lëndës, shihet se janë të bashkangjitura:

- Kopja e listës poseduese e datës 24 janar 2006, nr. 987, evidenca nga ngastra kadastrale nr. 1357/2, e evidentuar në emër si pronë shoqërore – shfrytëzues NTSH “16 N”,
- Kopjet e skicës së pronës kontestuese,
- Kopja e shkresës, datë 7 prill 2009, drejtuar kryetarit të Kuvendit Komunal J, nga ana e AKP,
- Kopja e Aktvendimit, nr. 3/348 datë 4 mars 2010, lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës – Zyra Kadastrale Komunale në J, mbi lejimin e regjistrimit të pronës kontestuese nga NTSH “16 N” tani tek Bashkësisë Lokale – J.
- Kopja e Vendimit, nr. 001/1 datë 26 qershor 2009, lëshuar nga Kuvendi Komunal J, që prona kontestuese të regjistrohet në emër të paditurës, Komuna e J,
- Kopja e Aktvendimit nr. 351-53 datë 28 prill 1983, lëshuar nga Kuvendi Komunal D, me të cilin të NTSH “16 N” i është lejuar ndërtimi i objekteve, dhe
- Kopja e planit, e pronës kontestuese, datë 8 nëntor 2015.

Disa veprime procedurale janë ndërmarrë, nga ana e GJTHP-DD, si ajo mbi obligimin e të paditurës mbi parashtrimin e përgjigjes dhe seancave gjyqësore të mbajtura, me 4 nëntor 2015 dhe 17 qershor 2020.

Përfundimisht GJTHP-DD, me Aktvendimin e saj datë 17 qershor 2020 (numri sipas programit SMIL -2019:150738), shpallet jo-kompetente dhe lëndën e referon për vendosje pranë DHPGJS.

Lënda gjer me datën 18 shtator 2023, mbahet pranë GJTHP-DD.

Lënda, me akt përcjellës, pranë DHPGJS dorëzohet me 21 shtator 2023.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, e paditura Komuna e Junikut, me 2 tetor 2023, parashtror përgjigjen në padi së bashku me kundërshtimin mbi propozimin për lëshimin e MS.

E paditura kundërshtor padinë me propozimin mbi lëshimin e MS duke e konsideruar si të pabazuar. E paditura fillimisht pohoj se paditësja me asnjë provë nuk ka dëshmuar se ka rrëzuar objektin e NSH, ashtu siç edhe obligohet sipas nenin 7 të Ligjit për procedurën kontestimore (“*barra e provave*”). E paditura, tutje konsideron se kërkesa për MS nuk i plotëson kriteret ligjore, të parapara sipas nenit 61 të Ligjit nr. 06/L-086 për DHPGJS (në tekstin në vijim: Ligjit për DHPGJS). Nga gjitha arsyet propozon që padia dhe propozimi mbi lëshimin e MS të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata duke marr në konsideratë kohën e gjatë të kaluar, nga momenti i dorëzimit të padisë dhe propozimit mbi lëshimit të MS, pranë GJTHP-DD e gjer në momentin e dorëzimit të shkresave të lëndës pranë DHPGJS (vitit 2010 gjer 2013), me datë 3 tetor 2023 lëshoj një urdhër për paditësen-AKP, me të cilën ju kërkua që të deklarohej, si në vijim:

- nëse mbetet pranë propozimit për lëshimin e masës së sigurisë –masës së përkohshme (MS),

Nëse mbetet atëherë:

- Në pajtim të nenit 61.1, të ofroj prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit, dhe
- Cili do të jetë dëmi e që do të konsiderohej si i “pariparueshëm” e që nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar, pasi që edhe me padi është kërkuar kompensim dëmi – kompensim financiar.

Me përgjigjen e saj, e parashtruar pranë DHPGJS, me 12 tetor 2023, paditësja ndër tjerash deklaroj, se për shkak kohës së gjatë të kaluar; të ndryshimit të rrethanave faktike dhe se për shkak se tani më e paditura ka ndërtuar objektin caktimi i MS nuk do të prodhonte kurrfarë efekti juridik dhe do të ishte tej mase i vonuar.

Paditësja nuk deklaroj shprehimisht nëse tërhiqet nga propozimi për lëshimin e MS.

Paditësja, megjithatë, mbeti në tërësi si pranë padisë për kompensim dëmi.

Arsyetimi ligjor:

Në pajtim të nenit 61.1 të Ligjit për DHPGJS, gjakata mund të nxjerrë MS me kusht që parashtruesi të jep prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet një MS. Sipas nenit 61.1, dëmi konsiderohet si i ‘pariparueshëm’ vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Pala, në parim duhet të ofrojë prova të besueshme se do të rezultojë me dëmtim të *menjëhershëm* dhe të *pariparueshëm financiarisht* nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kritere janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet.

Barra e provave bie mbi paditësin.

Në rastin konkret gjykata konsideron, ashtu si edhe vetë pala paditëse deklaroi me parashtruesin e saj datë 12 tetor 2023, se në rastin konkret shkak i procedurave të tej zgjatura dhe mos vendosjes nga ana e GJTHP-DD mbi propozimin mbi MS nuk ekzistojnë më kushtet e parapara ligjore sipas nenit 61.1 të Ligjit për DHPGJS që një masë e sigurisë të caktohet. Kjo për faktet si në vijim:

- kur tani më në pronën kontestuese është ndërtuar objekti nga e paditura ashtu siç edhe pala paditëse vetë e pohon, dhe
- e gjithë kjo me arsye, siç edhe është cekur në pjesën tek “rrethanat faktike dhe procedurale të këtij vendimi”, nga koha e parashtrimin të padisë dhe propozimit për lëshimin e MS e gjer tek dorëzimi i lëndës pranë DHPGJS nga ana e GJTHP-DD, kanë kaluar 13 (trembëdhjetë) vite dhe GJTHP-DD nuk ka vendosur asnjëherë mbi propozimin mbi MS andaj edhe arsyet mbi lëshimi e saj tani më nuk ekzistojnë.

Andaj, pa paragjykim të vendosjes së plotë lidhur mbi padinë, gjykata konstaton se në këtë rast, nuk ekzistojnë më dëshmi të besueshme, që do të arsyetonin lëshimin e MS. Nuk qëndrojnë më kushtet ligjore mbi ekzistimin e rrezikut të dëmit dhe për tepër kushtet që do argumentonin që dëmi i menjëhershëm dhe i riparueshëm do të shkaktohej në qoftë se MS nuk do të lëshohej, pasi që tani me ndërtimin e objektit në pronën kontestuese dëmi tani më është shkaktuar.

Andaj nga gjitha arsyet e cekura si më lartë kërkesa për lëshimin e MS nuk i plotëson kriteret ligjore ashtu siç parashihen sipas nenit 61.1 të Ligjit për DHPGJS.

Nga të gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet

Paditësja ka paguar taksat gjyqësore.

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë i mbulon shpenzimet e veta.

Këshilla ligjore

Në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS, apeli kundër këtij aktvendimi parashtrohet me shkrim për Kolegjin e Apelit të DHPGJS në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar kryesues

Diellza Hoxha, Gjyqtare

Hasim Sogojeva, Gjyqtar
